VENDIM
Nr. 1, datë 7.2.2013

PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NË ZBATIM TË FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 119, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin në vlerën 1 677 288 969 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, pjesë e fondit të buxhetit të vitit 2013, për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, për infrastrukturën vendore, të ndarë si më poshtë vijon:

a) vlerën prej 299 803 126 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, për likuidimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

b) vlerën prej 1 377 485 843 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekësh, për projekte në zbatim të infrastrukturës rrugore, sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë veprimet për bërjen efektive të fondeve.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha